



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT

NJËSIA E PROKURIMIT

Burrel, më _____._____.2023

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – MALLRA”

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje naftë për emergjencat civile të bashkisë Mat”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09134000-7 Naftë.

VLERA E FONDIT LIMIT:

1 000 000 (një milion) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, dhe nenit 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/ enti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1/1;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021**, dhe **2022**, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.
- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021**, dhe **2022**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, *ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b** dhe **3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare**;... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.**

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2020, 2021, 2022) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”** (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 40 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencë për stacionin e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë (e vlefshme) sipas ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 (i ndryshuar), dhe VKM-së Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (i ndryshuar).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5** e vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;**

Në ligjin **Nr.8450, datë 24.02.1999** “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

Neni 11 - Personat juridike, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon:... **ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete;**”

Neni 15 “Stacionet e shitjes së karburanteve”, - **1. Veprimtaria e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikante, ku përfshihen nënproduktet e kategorive I, II, III dhe IV/A, kryhet nga stacionet e shitjes së karburanteve.**

Stacionet e shitjes së karburanteve janë persona juridike, që themelohen në një nga format e shoqërive të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me licencën përkatëse, sipas këtij ligji, me kusht që ndërtimi i instalimeve dhe funksionimi i tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë të jenë në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara nga ministria.

Neni 17 - Personat juridike që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, **perpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përkatëse janë të detyruar të pajisen me leje koncesioni, leje tregtimi ose autorizimi.**

Neni 20 “Licencat” - **1. Licencat u jepen personave juridike, të parashikuara në pikat "ç" dhe "d", të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës dhe vajrave lubrifikante për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lendeve djegëse (njësitë e shitjes së lendeve djegëse).**

2. Licencat për personat juridike, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave me **Nr.970, datë 02.12.2015** “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (i ndryshuar), parashikohet se, citojmë: “**II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.**

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

a) **Ministri që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni i karburanteve do të ndërtohet në autostradë;**

b) **Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.**

2. **Për marrjen e licencave për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete e vajrave lubrifikante, personi juridik duhet të paraqesë, pranë organit që ka të drejtën e dhënies së licencës, këto dokumente: e) Autorizimin hyrje-dalje në rrugë, të lëshuar nga enti pronar i rrugës;**

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit vlerëson se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **liçencën për tregtimin me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë** e kërkuar, e cila duhet të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave, me qëllim verifikimin se operatorit ekonomik është i liçensuar për tregtimin e me pakicë të karburanteve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin për kapacitetin profesional të ushtrimit të veprimtarisë si më lart duke qënë se ky kriter është i detyrueshëm, është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, të operatorëve ekonomikë për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) pikë furnizimi me vendodhje në Njësinë Administrative Burrel/ Bashkia Mat, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontrate noteriale qiraje - *me kohëzgjatje në përputhje me afatin e kontratës*). Ky stacion furnizimi të jetë i pajisur me leje mjedisore, Vërtetim Teknik nga ISHTI ose nga një shoqëri e akredituar, Akt-Teknik nga PMNZH, dhe Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për shitjen me pakicë. *Për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqitet i gjithë dokumentacioni i cituar.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2022.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rastin kur nuk është shoqëri tregtuese me shumicë, duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar të furnizimit me një shoqëri e cila është e liçensuar për tregtimin me shumicë të produktit që prokurohet.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë-analizën e kontrollit të kryer në stacionin e tij, dhe/ose të furnizuesit të produktit, për produktin **Diesel 10 PPM S SH EN 590:2022 ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare**, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (*n.q.s është laborator i huaj duhet e përkthyer dhe e noterizuar në shqip*), që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike e lëshuar jo më parë se muaji Korrik 2023.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 3, 5 dhe 8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkoni**” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e 1 (një) pikë furnizimit/ stacion shitje është i domosdoeshëm për furnizimin e automjeteve të autoritetit kontraktor me mallin objekt prokurimi, ku duhet të paraqesë dokumentacionin ligjor të kërkuar për vërtetimin e disponimit të tij dhe ushtrimin e veprimtarisë në të sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, referuar nenit 15 të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” (i ndryshuar), Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (i ndryshuar), ligjit Nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar me ligjin nr.52/2020), Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.491, datë 19.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, dhe Urdhërit nr. 315, datë 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”.
2. Me qëllim vërtetimin e besueshmërisë të operatorit ekonomik pjesëmarrës se ai ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqipëtar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje cilësie, në mbështetje të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore, VKM Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”, Urdhërit të Ministrit Nr.06, datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse”, Njësia e prokurimit vlerëson se operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e kërkuar, lëshuar nga ISHTI.
3. Në zbatim të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” neni 15 pika 2 të tij, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë në rastin kur nuk është shoqëri tregtuuese me shumicë, duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar të furnizimit me një shoqëri e cila është e liçencuar për tregtimin me shumicë të produktit që prokurohet.
4. Gjithashtu, në zbatim të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” neni 23 i tij, VKM-së Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”, si dhe Urdhërit të Ministrit Nr.06, datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të

*saj, procedurat dhe tarifat përkatëse”, me qëllim verifikimin se produkti që operatori ekonomik oferton **Diesel 10 PPM**, është sipas standartit **S SH EN 590:2022 (Diesel 10 PPM) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare** të kërkuar në dokumentat standarte të procedurës së prokurimit, Njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin fletë-analizën e kontrollit të kryer në stacionin e tij dhe/ose të furnizuesit për produktin objekt prokurimi, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike e lëshuar jo më parë se muaji Korrik 2023.*

Kapacitetet dhe dokumentacioni ligjor i kërkuar, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur duhet të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacion të shitjes së karburantit me pakicë në pistoletë publike me shërbim 24 orë në çdo ditë të javës, deri në përfundim të Kontratës dhe me vendndodhje në Njësinë Administrative Burrel/ Bashkia Mat me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona në formë biletash, në adresën e kërkuar dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme për periudhën, vitet 2023-2024.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.
- Disponimi/ Ekzistenca e ndërfaqes së menaxhimit të karburantit (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kërkuara mësipër, do të demonstrohen nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani anëtarëve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

Mosofrimi i Ndërfaqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale;** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5 dhe 8** e Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.** 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit me anë të këtij kriteri kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se marrin përsipër furnizimin e produktit sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, dhe disponojnë ndërfaqe të menaxhimit të karburantit (webpage) për sigurimin e shërbimit të furnizimit me karburant në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 561, datë 29.07.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin për aftësinë teknike si më lart duke qënë se ky kriter është i detyrueshëm, është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen se, vërtetë operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë aftësitë e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar referuar nevojave të autoritetit kontraktor dhe në përputhje me standardin evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH), bazuar në kërkesat që përcaktojnë dispozitat ligjore dhe nënligjore të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (i ndryshuar), dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik¹”, dhe nenin 40 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 21.08.2023, ora 10.00, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al** .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT